INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE | DITARI MUJOR

BULETINI MUJOR

NËNTOR 2025

IKTK
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

MBROJTJE, RESTAURIM DHE PROMOVIM I TRASHËGIMISË KULTURORE E HISTORIKE

Manastiri i Ungjillizimit në Vanistër, Manastiri i Fjetjes së Hyjlindëses në Raven dhe monumente të tjera me vlera të veçanta në Goranxi

Një bashkëpunim mes **MTKS, IKTK, DRTK Gjirokastër, Bashkisë Dropull, Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë dhe komunitetit,** ndihmoi në fuqizimin e punës për mbrojtjen, restaurimin dhe promovimin e trashëgimisë së pasur kulturore e historike të zonës.

Në kuadër të përgatitjes së një aplikimi të përbashkët **IPA,** koordinuam hartimin e një strategjie të integruar që synon *shpëtimin, restaurimin dhe rijetëzimin e disa monumenteve*, përfshirë projektet e ***Manastirit të Ungjillizimit në Vanistër, Manastirit të Fjetjes së Hyjlindëses në Raven*** dhe monumente të tjera me vlera të veçanta në ***Goranxi.*** Njëherazi, do të *zgjerohet lista e pasurive kulturore* përmes shpalljes së interesit kulturor për objekte që ruajnë traditat dhe teknikat karakteristike të zonës, si ***Kisha e Manastirit të Kryeengjëjve*** mbi fshatin ***Derviçan***, e cila do të përfshihet në vijim në procesin e restaurimit.

Gjatë periudhës 2024-2025 kemi nisur dhe kryer ndërhyrje pastrimi, mirëmbajtje e restaurimi, në numër e vlerë investimi si kurrë më parë, por inventari e pasuria e jashtëzakonshme e zonës, si dhe urgjenca e nevojës për më shumë fonde e projekte kërkon sinergji e financime alternative të rëndësishme.









INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE | DITARI MUJOR

BULETINI MUJOR

NËNTOR 2025

IKTK
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

TAKIM SHUMËPALËSH
MANASTIRI I SHËN KOLLIT, MESOPOTAM







Në **Manastirin e Shën Kollit** u zhvillua një takim shumëpalësh mes përfaqësuesve të IKTK-së, DRTK Vlorë, Qendrës Evropiane për Studime Bizantine dhe Pasbizantine (Selanik), përfaqësuesve të Ministrisë Greke të Kulturës dhe ekspertëve të trashëgimisë kulturore.

Takimi u mbajt në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe Qendrës Evropiane për Monumentet Bizantine dhe Postbizantine, me **projekt pilot** konservimin dhe restaurimin e pikturës murale dhe elementeve dekorativë në kishën bizantine të Shën Nikollës në Mesopotam.

Diskutimet u fokusuan në adresimin e çështjeve të reja të dala gjatë zbatimit të projektit dhe përcaktimin e hapave të mëtejshëm për ruajtjen e kësaj pasurie kulturore unike.





INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE | DITARI MUJOR

BULETINI MUJOR

NËNTOR 2025

IKTK
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

GËRMIM ARKEOLOGJIK

Kthellë e Epërme, Mirditë.

Gjatë muajit Nëntor u realizua gërmimi arkeologjik i shpëtimit në zonën e Kthellës së Epërme, në Mirditë, nga arkeologët e Drejtorisë së Shërbimit Arkeologjik në IKTK, me mbështetjen e Bashkisë Mirditë.







Të dhënat arkeologjike nga kjo zonë janë tepër interesante, të shoqëruara edhe me një ***toponimi të pasur dhe domethënëse,*** e cila dëshmon për aktivitet njerëzor duke filluar nga periudha e ***Hekurit të Hershëm*** e deri në atë të ***Antikitetit të Vonë.***

Hulumtimi dhe gjurmimi arkeologjik do të vijojë dhe priten rezultate të rëndësishme për njohjen dhe zbulimin e ***thesareve të trashëgimisë kulturore*** të zonës së Mirditës dhe më gjerë.











INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE | DITARI MUJOR

BULETINI MUJOR

NËNTOR 2025

IKTK
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

KONSERVIM-RESTAURIMI I PIKTURËS MURALE DHE IKONOSTASIT NË KISHËN E MANASTIRIT TË SHËN MËRISË,

Spile - Saraqinisht - Gjirokastër

Kisha e Manastirit të Shën Marisë së Spilesë në Saraqinisht është ndërtuar në vitin **1634.** Piktura murale është realizuar po në vitin 1634 nga mjeshtri **Mihal Linotopi.**









Pas përfundimit të restaurimit të arkitekturës së kishës gjatë vitit 2025, me financim nga buxheti i shtetit, në tre muajt e fundit të këtij viti, po me financim nga buxheti i shtetit, po kryhen punime konservuese- restauruese në pikturën murale dhe ikonostasin e kësaj kishe.

Ndërhyrjet përfshijnë:

- Konsolidimin e shtresave përgatitore dhe të pelikulit piktorik,
- Pastrimin nga depozitimet e qëndrueshme,
- Stukimin dhe integrimin piktorik të pikturës murale,
- Konsolidimin, pastrimin dhe sistemimin e ikonostasit të kishës.







INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE | DITARI MUJOR

BULETINI MUJOR

NËNTOR 2025

IKTK
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

INSPEKTIM NË TERREN
NË PARQET ARKEOLOGJIKE TË ORIKUMIT DHE AMANTIAS

Inspektim në terren, zhvilluar në kuadër të procesit të përditësimit të zonifikimit arkeologjik dhe hartimit të rregullores së administrimit për parqet arkeologjike të Orikumit dhe Amantias, në bashkëpunim me specialistët e DRTK-Vlorë.







Inspektimi në terren përfshiu disa veprime kryesore:
• Dokumentimin fotografik të zonave arkeologjike dhe elementeve me interes të veçantë;
• Identifikimin dhe pozicionimin në hartë të sektorëve me potencial arkeologjik, si dhe të zonave që kërkojnë ndërhyrje ose studime të mëtejshme;
• Hartografimin përmes marrjes së koordinatave në terren, me qëllim krijimin e një baze të saktë referuese për proceset e zonifikimit dhe administrimit.



